

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli i Ministrave**

**V E N D I M**

**Nr. 650 , datë 14.9.2011**

**P Ë R**

**LICENCIMIN E AKADEMISË SË STUDIMEVE TË APLIKUARA**  
**"REALD"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Licencimin e akademisë së studimeve të aplikuara "REALD", e cila do ta ushtrojë veprimtarinë e saj në qytetin e Vlorës.
2. Akademia e studimeve të aplikuara "REALD" do të organizohet në dy fakultete:
  - a) Fakultetin e Shkencave Mjekësore, që do të ofrojë programin e studimit të ciklit të parë në "Infermieri", si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në:
    - i. "Stomatologji";
    - ii. "Farmaci".

b) Fakultetin e Ekonomisë që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në:

- i. "Marketing";
- ii. "Financë";
- iii. "Menaxhim".

3. Akademia e studimeve të aplikuara "REALD" do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, në "Infermieri"; "Marketing"; "Financë"; "Menaxhim", që do të realizohen me 180 kredite dhe me kohëzgjatje normale 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve të studimit do të lëshohet diplomë universitare "Bachelor" përkatësisht në:

- a) "Infermieri";
- b) "Marketing";
- c) "Financë";
- ç) "Menaxhim".

4. Akademia e studimeve të aplikuara "REALD" do të ofrojë programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë në "Stomatologji" dhe "Farmaci", që do të realizohen me 300 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 5 (pesë) vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve të studimit do të lëshohet diplomë universitare "Master i shkencave" përkatësisht në:

- a) "Stomatologji";
- b) "Farmaci".

5. Akademia e studimeve të aplikuara "REALD" ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit të ri akademik, lejen përkatëse nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.


6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të miratuara, bëhen pas miratimit nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.

7. Akademia e studimeve të aplikuara "REALD", Vlorë, duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimeve, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi dhe për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

MYQEREM TAJAJ



NR.PROT.2677/1  
DATË 30.9.2011

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

